


BIBLIOTEKA  
SHTETIT

884-1  
5429




# Sipahi e Malcive Rëmnia



814-1  
SH29

NOVRUZ SHEHU

# Lirikë e maleve të mia



20764  
18858

Vjersha

Qytetar 1000 vjetor - 1000 vjetor - 1000 vjetor - 1000 vjetor

KOMUNIKATI BOTOLQAR - Shqipëri

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## I R P A R T I

Në ngritjen e metalurgjikut  
e në turbinat e kolosëve të elektricitetit,  
në vullnetin e çeliktë të novatorit,  
që me dorën ngritur i thotë importit «ndal»,  
në zemrat e dy milionë e treqind mijve,  
në betimin e veteranëve «Për gjakun e shokëve»,  
në ballin e tridhjetë e pesë nëntorëve  
e të gjithë nëntorëve që do të vijnë,  
në fjalët e fundit të atyre që vdesin  
e në fjalët e para të të porsalindurve,  
në gjithë luftërat e drejta të popujve  
që kërkojnë me armë në dorë lirinë,  
në grushtin e pakundërshtueshmë e të revoltuar  
përplasur në tryezën e superfuqive  
është ajo  
që për të malet tonë shkëmbinjtë zhvendosin  
dhe emrin e saj shkruajnë: PARTI

## K R E N A R I

Biro, sa tē pashë tē vrarë  
më vajti dora te balli,  
atje plumbi tē kish marrë.

Atje tē kish zënë  
se në djep tē pata thënë:  
«Ja në ballë, ja rri pa rënë!»

## ËNDRRA E NJË BARIU NË PLAZH

Një bari në plazh me studentët  
shëtiti dy javë buzë detit,  
në mbrëmjen e fillimit shikimi  
në shpinat e dallgëve i mbeti.

Kopetë e kooperativës me zhurmë  
i erdhën pranë sa sytë mbylli,  
dallgët si miliona shelegë  
vraponin në fusha tërfili.

Dhe vetullat vrenjti në ëndërr,  
me rërë mbushi grushtin dhe tha:  
«Kthei nga shtrunga, ktheu anën!  
Vajti ora për të mjelë, mor vëlla.....»

## KORRËSET

Qeshin, qeshin korrëset  
me vrapn' e zefirit,  
qerpikët ua prek  
qerpik i kallirit.

Dël hëna nga malet  
drapër i florinjtë,  
vjen era nga pllaja  
puthet me kallinjtë.

Një tufë me thëllëza  
turret të shohë tutje,  
një drapër mbi male,  
njëqind përmbi supe,

Kombajna në fusha  
drapërinjtë në male,  
zënë kallinjtë nga gusha,  
zënë kallinjtë në valle.

Ngrihet vrulltaz dielli  
qiellit si shami,  
që ta marrin korrëset  
ta hedhin mbi sy.

Ta mbushin me këngë,  
ta mbushin me grurë,  
në lëmë ta shpalosin,  
ta bëjnë flamur...

## KOSTUMET KOMBËTARE

Dimri më shpejt se kudo vjen në male,  
po njerëzit këtu si askush duan lulet  
ndaj qëndisën aq shumë në jelekë  
lulëzimin që tufani s'e përkul.

Ndaj qëndisën lule në çdo tirq,  
në sila, mitanë e në shami.  
Sa herë që hidhen në tribunë festivalesh  
ka një pranverë në trup çdo njeri.

## VDEKJA E NAIMIT

Baresha mbajti dorën te dybeku,  
la vedrën të derdhet nga harrimi.  
Iu këputën mbi gjinj sumballa jeleku:  
— Vdiq Naimi!

Rrahën tirqet mbi gjunjë fustanellat,  
në silarë ngriu duart trishtimi,  
m jegulla mbi male uli vallon:  
— Vdiq Naimi!

Qetë zvarisën ploret në lëndinë,  
Lulet e Verës njëherësh ulën kokën:  
— Vdiq Naimi!

U bënë lumenjtë klarineta,  
malet daulle kushtimi,  
gjithë pyjet cula dyjare  
për Naimin...

## LIRIKË E VAJZAVE TË FSHATIT TIM

Zanat kanë dalë nga legjendat,  
të bukurat e dheut nga përrallat.  
Janë vajzat e fshatit tim  
çdonjëra një lirikë e rrallë.

Këndoijnë bilbilat në kalatë e lashta,  
këndoijnë vajzat në fshatin e ri.  
Rritet këngë e grurë në malet e larta,  
duart e tyre kullojnë flori.

Zanat kanë dalë nga legjendat;  
nga gjoksi, xhurasë, nga teli lahutës.  
Janë vajzat drenusha të fshatit tim,  
çdonjëra Shotë, çdonjëra Shkurtë.

## RROFTË PARTIA KOMUNISTE

Plumbat i korrën njëherësh gjethet,  
gjethet mbuluan trupin e tij.  
Gjaku ngjyrosi gjelbërimin e korru,  
ia qëndisi trimit flamur mbi gji.

Trimat pyetën njëri-tjetrin kush e njihte,  
nga ç'fshat ish, nga ç'qytet, nga ç'brigadë.  
Dy sy si krerë shkabe zbukuronin flamurin  
dhe një grusht mbi tëmth si granatë.

Ngritën trimat trimin nga shkëmbi,  
(bajoneta ende shkëmbin griste ).  
Batalioni lexoi gatitu, grushtngritur:  
— Rroftë Partia Komuniste!

## BALADË PËR MEMO METON

— Memo! Një shok na i vranë!  
Memua shpejt një këngë.  
Në vend të trimit e plotë ngrihej kënga,  
rrézonte shtatë armiq një e shtënë.

Por Memon një ditë e goditi  
me plumba qafiri.

I rrodhën Memos mijëra pika gjaku  
e mijëra këngë nga gjiri.

U afrau Liria e puthi në ballë  
Memo oratorin.

U afruan shokët e puthën në buzë  
Memo këngëtorin.

U afroan nénat e puthën tek këngët  
ku kishin bijtë.

U afroa flamuri e puthi tek dora  
që shuajti armiqtë.

U afroan lulet, u ulën mbi plagë,  
aty hodhën rrënje.

Afrohen vitet, e marrin në duar,  
përmbi ballë e vënë.

U għilu u qiegħi u qiegħi  
ka kieni idha u qiegħi  
eż-żejt idha u qiegħi  
għidha u qiegħi

U għadha u qiegħi u qiegħi

## B L U Z A T

Vallē i ka mardhur bora,  
shiu supet ua ka lagur?

Dyzet me një miję, u əshté dredħur dora,  
dyzet me një miję, a janë shtangur?

Vallē llogoret bërrylet ua kanë grisur,  
stralli shollët ua ka grirë?

Vallē nga Ċermenika sot janë nisur,  
thëllimi buzën ua ka nxirë?

Dhe nëna i pa tek haheshin me plumbat,  
ku kosё e luftës sheshonte gérxh e drurë.  
«Mbah, bijtë e nënës, hallall gjiri,  
hallall dyzet bluzat që kam prurë!»

shkurt iden historieqë mësuespërte n.t.  
Bashki qënd i ëmboj

zgjedha është mërisje sëmuajt  
Zgjedha është liga është zëdhënësi që  
zgjedha është shtë e lirës së zotit

## PARTIZANES ME EMRIN E LIRISE

L. Geros

Qielli ngjyrën e tij  
ia uli mbi sy.  
Dielli ballin e zjarrtë  
ia uli mbi gji.

Kallinjtë e grurit u thurën  
në sup të saj gërshetë.  
Shqiponjat krahët i dhanë,  
tufanet këngën e sertë.

Se kërkonte Partia në male  
trima me çap suferinë.  
Në çdo pëllëmbë të atdheut  
Liria kërkoi Lirinë.

Tek u sulej armiqve përballe  
plumbat mbi tokë e shtrinë.

Ju shpleksën gërsheetat mbi trakte,  
puthi Liria Lirinë.

I vunë zjarrin në shtat,  
në këmbë, në gjë, në shpinë.  
Por me buzët e arta prej flake  
Liria këndoi Lirinë.


## PËRJETËSI

(W. Aitken)

E varën  
se deshi njerëzit,  
se deshi lirinë!

Këmbët s'i preknin dot tokën,  
sytë s'i shihnin dot qiellin;  
atë natë dhe yjet mërdhinin.

Por ai qëndroi aq mirë, aq i qetë  
në zemrat e njerëzve që s'fjetën.



## DIALOG NË QELI

(M. Alimanit)

Kamxhik, hekur, gjilpëra, dhembje  
dhe klithmë e gjermanit:

— Kufoma jote në litar do varet!

Një zë i qetë nga buzët merr udhë:

— Po jo malet!

Flokët e përgjakura tund mbi ballë:

— Po jo lirinë!

Sytë i digjen si dy zjarre në shtigje:

— Po jo këngën time...

## ATYRE QË NA LANË KËNGËT

Jua preu mesin sqepari e guri këmbët,  
o të pa fjetur e të uritur aq shumë,  
por nuk i latë rrugëve këngët,  
nuk i latë këngët në gjumë.

Se në to zërat-krisma Çerçizët  
lëshonin, tundnin mjekrat si retë,  
gjunjëzoheshin të mundur vezirët,  
i zhduknin nën vete rrëketë.

T'u linit brezave pasuri nuk patët,  
se gjakun jua pinë mbretërítë,  
por bashkë me parmandën mbajtët shpatat  
dhe me këngë na nisët trimëritë.

## O KËNGËT VËNCE

O këngët popullore, këngët vënçe,  
sinonim i tokës, zemrës sonë!  
Që kur kini, sa vite, sa shekuj,  
sa jeni vallë, sa mijë, sa milionë?

Etruskëve u mbetën vetëm gurë varri,  
ju qindra mijëra shekuj rezistuat,  
Megjithëse u ranë miliona barbarë  
gjithnjë të ndershme e të mira qëndruat.

Me mijëra gjokse nxjerrin një zë,  
me mijëra mendje thurin një këngë,  
ndaj dhe maleve flokët e pyjeve u ranë,  
po ju një fije forc' nuk ju ka rënë.

Qindra mbretër, vezirë, hoxhallarë  
të ndërronin formë, ulërinin,  
por ju qeshët shpalosur fustanellash  
si ta dinit ç'do t'ju bënte komunizmi...

Dhe ja, me ne të forta e të bukura  
ngrihi të partishme e të mençme.  
Sinonin i tokës, zemrës sonë,  
o këngët popullore, këngët vënçe!

### TRIKA E MAFTEË TE MIA

Kasdizatë, kasdizatë  
shtetit ushqërit ujës.  
E agjor qëlli kashqës  
tokës pukgëvajtë.

Djalëtës së a qyjetës qarri  
muziqë i dhëndizës  
këngëtë bot me gërmë  
bajt me pësirët mirë.

I ujto sës pukgës, e pukgës  
dje këngë si mërtë:  
qëpëriti mi, bëjëndoni i atje  
kudo ka bëzavejtë...»

I këu këngë tutje mërrë  
dje i këshpëti bërës:  
«T'i ujg i ujg jashtë tjetrit  
tek bëjënduni, i ujg...»

Dhe is, me te t'jona e të pukurin  
uqitja të besitjeve e të mençave  
Sionin i fokës seminë sone  
o këngët bopullore, këngët vënëse!

## LIRIKA E MALEVE TË MIA

Kuadrate, kuadrate  
arat nëpër male.  
E ngroh dielli kaldajë  
tokën bukëvale.

Dhjetra sy e dhjetra duar,  
malit i qëndisin  
kuadrate plot me grürë,  
plot me blerim misri.

I ngre sytë bujkesh' e bukur,  
një këngë ia merr:  
«Fshati im, gjerdan i artë,  
kudo ka pranverë. . .»

Ikën kënga tutje malit,  
dhe i kthehet prapë:  
«Ti më je një lule rrallë  
tek gjerdan' i artë». . .

Dëgjon vasha, ndërpret këngën  
po kënga nuk pritet:

«Ti më je tek kjo pranverë  
lule që s'venitet...»

Erdhi koha të qeth dhentë,  
siç i qeth ti arat,  
unë do mbush plot kombinatin,  
ti do mbuç hambarët...»

Dëgëlon vesprë uqëlibet këndësu  
bo këndësu uqë bittët  
-Të wëg jë se për kjo bimavëte  
inje është vërtetët

Erdhi koha të detyrave  
**KËNGË NË MALE**

Ku mbështetej lugina mbi gjoksin e malit,  
mbështeti korrësja flokët mbi gjoks të kosëtarit.

Morën xhuratë sa i panë barinjtë,  
mbi ta u ngrit hëna si def i florinjtë.

Me dritë e me këngë gjithë mali u mbush,  
katër duar gërshtat shpleksnin nën një gushë.

Këndonin barinjtë, korrësja, kosëtarit,  
mbante iso kombajna, si gajdë fryhej mullari...

## BARI MES BARINJVE

Qengji tund kokën, cjapi këmborën,  
era gjethet; heshtjen xhuraja,  
unë mësues u bëra në veri  
dhe bari ku ulen ëmbël pllajat.

Në banka auditori shumë mësuam,  
shumë mësuam por prapë qenkan pak,  
pa qenë në të tilla banka malesh,  
bari mes barinjve me shark.

Bari mes barinjve në male  
ku me emra heronjsh tregohen gurët,  
ku shoqet e fëmijnisë vijnë me hënë  
të kthejnë shkëmbinjt' në toka gruri.

Qengji tund kokën, cjapi këmborën,  
era gjethet, heshtjen xhuraja.  
Vërtet, ç'mrekulli në mes barinjve  
me xhura ku ulen ëmbël pllajat!

## MESNATË DETARE

Mjekrat krehin dallgët,  
ç'do brazdë shpejt humbet.

Në luspat e peshqve yjet  
impliksen e thyhen në rrjetë.

Dallgët ngjishen në kic,  
mes nesh motivet e detarëve.

Në sytë e peshkatarit të moçëm  
krip detin me lotë «vajzë e valëve».

Me krenarinë peshkatare  
marrim me vete madhështinë e kaltërt.  
Si strofa të një poeme detare  
afrohen në breg motobarkat...

TER AVDITET MIRI  
B E T O N I E R E S

Kur rrezet e diellit fytyrës të rrëshqasin,  
«Të pamë me flokëverdhin».. shoqet se ç'të ngasin.

Çelësin e motorinos e ngrë e tronditur,  
me zhurmë betoni të mbytësh zënë e ngritur.

Trazohet cimentua me rërë e gëlqere;  
«E, ç'mur do lidhet e shtrenjtë betoniere.

Të lumtur do rrojmë në shtëpinë e re!..»  
Të mbytësh zërin pse çelësin s'e ngre?

## TEK VADITET MISRI

БЕТОНИРЯС

Uji largohet,  
uji afrohet,

dy shata godasin mbi tē.

Andej nga vjen uji

dy vetulla dridhen,

shikimi shikimin e zë.

Hëna copëzohet

në dhjetëra kanale,

ngjyrosset peisazhi jeshil.

Agimi i bukur

me krahun e kaltërt

mbulon në vetvete çdo yll.

Sivjet sa mirë,

sivjet sa shumë

do kemi misër tē ri.

## VRASJA E BALLANIT<sup>1)</sup>

Delet lanë kullotën, delet heshtën,  
gjyzat e këmborëve më s'ranë,  
bariu rrahu fanellën e leshtë;  
«— Bobo, mos mbetsha, mbeta pa Ballanë!»

Qentë varën veshët me lehje të hidhur,  
bariu mbi bar festen flaku,  
grindeshin retë nga éra e shtrydhur,  
heshtëtë në xhura këngë e përgjakur.

Por nga rrihte bishë, nga dyndeshin retë  
të ndërsejë qentë, i rreptë u ngrit bariu.  
Rrodhi nga xhuraja kënga përmbi shpate:  
— Ballan, Ballani ynë si veriu!...

Ballan, Ballani ynë që s'u lodhe,  
Ballan, Ballan, Ballan i mirë,  
po të marrim në xhura, në gjyzat e këmborëve  
se ti as i vrarë s'rri dot i shtrirë.

---

1) Ballani — emër qeni:

## ÇLODHJA E AGRONOMIT

Po çlodhet agronomi...  
Nën kokë plisat e pashkrirë,  
tërfili i gjelbër nën mes.  
Toka e mbulon  
me jorgan të avullt ugaresh  
e i hedh mbi sup pikave.

Një sy gjumë agronomi,  
mbi ballë i bien kallinjtë,  
mustaqet e misrit nën gushë.  
Mbi kraharor afrohen arat  
si nëna' të mira  
për bijtë me duar të mbushura.

Çlodhu, agronom,  
në arat, grunjat, pemishtet e tua.  
Gjithë petkun toka ta shtron.

## NËPËR GËRSHETAT E BLERTA

Çel sythat e gjelbër misri në kubikë,  
rezervuari gjirin hap t'i japë të pijë.  
Bujkeshat prekin damarët e çdo gjetheje  
siç prekin nënët e dhemshura fëmijët.

Zgjaten gjer tej rrështat e kubikëve  
si gërshta të blerta, të pleksura, të gjata.  
Dielli i majit derdh përmby ta  
tërë përparsen me rrezet e arta.

Sa shumë misër do të keni në tokën me vlagë,  
hej, ç'prodhim të mbarë do të kemi!  
Poemën e lumturisë shkruajmë në male  
pa harruar poemën e Migjenit.

NËPEL GJERSHETAT E BRETA  
MONOLOG PËR NËNËN

— *Kushtuar mësuesit Hero Ilia Qiqi*

Nënë, të kam kaq pranë  
sot këtu në bjeshkët prej pishe,  
në qiellin mbi ne mijëra re  
errësohen, dynden e ngjishen.

Më duhet të eci, të eci  
në këtë peisazh dimëror,  
në çdo hap më prek dora jote  
dhe pisha me gjëzofin halor.

II.

Nuk më harrohet, e si mund,  
firma jote në fletë taksidari,  
poret e gishtit të vogël  
ulje si gjurmë mbi bar.

Të kërkonin vlerë të korrash  
dhjetë herë e më shumë në vit,  
ta vriste revoltën në buzë  
fleta ku kish gjurmë gishti yt.

Vinte shpejtë në dritare Naimi  
të të mësonte shkrim nëpër natë,  
po sa mësoje një shkrönjë, nxitoje,  
donte gjalpë përpushkën im atë.

Se kohën ua kërkonte lufta,  
luftë, luftë e luftë prapë.

Në vatrën si hënë prej balte  
mbante zjarrin të ndezur një shkarpe.

### III.

### IV

Nxenësit më presin, nxitoj,  
ç'ke me të, ashtu e ka tufani,  
mos m'u lut, moj nënë, mos m'u lut  
të ngroh kokën te ti, nën mitan.

Dhe pak dhe stuhia do zbutet,  
do zgjaten ylberët si ura,  
do përpëlis qerpikët e lagur  
me bukurinë e përjetshme Lura.

#### IV.

C'kam ca nxënës tē bukur, moj nënë;  
tē shëndetshëm, tē mirë e tē pastër,  
në sytë e tyre vet dielli  
ngjyros peisazhin e kaltër.

Rrinë ndezur llampat elektrike,  
ata librat mbajnë hapur gjer vonë.  
Hëna shtyp hundën në xhamë  
si llampë 500 vatshe neoni.

Malet tonë në veri e jug  
ngjajnë me njëri tjetrin si binjakë.  
Jugorët, tē stralltë, janë gati për shkrepje,  
këtu pishat janë gati për flakë.

#### VI.

Kam pranë gjithë nënët, q'do bëje më tepër?  
Fli, pra, e qetë e mbylli sytë!  
Ai që shtyp inatin e stuhi së  
është komisar drite, biri yt...

## FËMIJNIA

### LËKTI

Fëmijninë  
të dalë nga kaçubet e viteve  
e thérres,  
por hesht ajo si të mos dojë  
të lëmë lojën mbyllasyza përmes.

Hesht,  
skuqet me pëllëmbët mbi sy,  
me pendim se kumbullat shkundi,  
hipën  
në çdo degë, por t'i ngjisë  
kokërrat e këputura nuk mund.

Dorën vë bori,  
me lot në sy bërtet,  
ndoshta e dëgjoj e rri me të.  
Më lutet  
të qëndroj, me premtim të plotë:  
«Rri se ç'bëra kurrë s'do ta bëj më!»

## FËMÎJËT

### LEJLEKËT

Një mëngjes fëmijët e lagjes u shtangën:

— Ç'u bënë lejlekët sqepshigjetë e krahëdallgë,  
ku vanë?

Fëmijët

me shqetësim i ngarkuan balonat,  
horizonteve i nisën,  
si petale rrëmbyer nga era.  
Ndoshta lejlekët i shohin dhe kthehen  
mbi plep si herët e tjera!...

Qiejt e syvë u vrenjtën,  
në stuhinë e shqetësimit,  
rrugë kërkuan balonat:

— «Mos i ka trembur ndonjë nga radhët tonë?»

Si t'i dëgjonin  
lejlekët rrahën krahët,  
fluturimin matën me balonat gjer vonë:  
— Ehej!... Ja tek qenkan!  
Çerdhe të re kanë ndërtuar  
mbi një shtyllë tensioni. . .

## MOTIVA KURBEITI

S i f hëgjionu

Iejjeket hësëgn këshqer!

Hënëminu mësën u pësonin qët e ngrënë

— Eppel! ... ja tek denqesu!

Cështje të te përdë udëtun

mid ujë spërdhëfisjon!

## MOTIV KURBETI

Nga lotët e mi  
deti u bë dy herë më i kripur;  
nga pritja ime  
deti u bë dy herë më i thinjur.

Nga lëngimi im  
dy herë më shumë lëngoi deti;  
nga hapi im  
gjithë gurët rruga i treti.

Etja ime  
dhe drurët e pyllit i thau,  
klithma ime  
malet mes për mes i çau.

Ku je, bir?  
Pa ty, në dhe, meraku s'do më tresë!  
Eja, bir!  
Shihe kandilin tek kënd' i penxheresë!

Eja, bir!

Dorë të vësh në pushkë e mbi parmendë!

Eja, bir!

Dhe baltë të hashë, është baltë e vendit tënd!...

## PERQENTITË E POETIT DE RADA

Tëpërve se poq se është  
Burrave që nuk mundëse  
Jeshi e usq përfundon do i shpërndi  
Nëna e mesme

Do bënveç që përshtatet liria i afërtëzuar  
Tëpërve që qëndron përfshillë  
Këtij kohë e përmendës u bëgjekujnë  
Tëpërve, usq së këtij bisken De Raga

Vërtetë qëndron së shpejtë, jepet që nuk bëhet  
Jedjat e përmendës u bëgjekujnë Qdhezë e përgatiste  
Qdo që qëndron së shpejtë që kësaj  
“Qëndron... usq qëndron... usq qëndron... us qëndron”

Duhet i vëll i shpëngj, përsas përgatit  
Tëpërve, këndi i të përgatit  
O Dëshmi Tëpërit me usq së këtij  
Tëpërit me usq së këtij

## PËRCJELLJA E POETIT DE RADË

*Thuhet se kur po e përcillnin për në  
varrezë, mbi arkivolin e poetit ranë  
lulet e një bajameje, që i shkundi  
era e maleve.*

Ish pranverë po bajamet lulet i shkundën.  
Ish pranverë po deti bëri dallgë.  
Konturet e pranverës u përkulën,  
heshtëte në arkivol plaku De Radë.

Njerëzit ngritën arkivolin, lulet ulën petalet,  
kangjellat mërmëritën Odisenë arbëreshé.  
Cdo hap përsëriste pandërprerë dy fjalë:  
«Të deshëm... na deshe, të deshëm... na deshe!»

Dallga i ra dallgës, bregu bregut,  
syri syrit, kënga i ra këngës:  
— O De Radë! Trupin ke në arkivol,  
të tërin të kemi në zemër!

Era fryu, bajamet i shkundi,  
njerëzit mbi supe mbartnin petale.  
Poeti De Radë qe bërë pranverë,  
poetin De Radë e mbartnin vargmalet.

## ОДШТЕТ

Одштет таңи ми көнүлгөп е постан  
ан маке дөнгөдүрмөн бүткөпсө.  
Одштет таңи ти мүнгү ти берилген  
жарынан са кийдең уза ела.

У айнан барын е барын току  
и айнан барын е барын току  
бай жас түркес жас түркес  
з'юнхол ти айлек ти маки ти жарын.

Олончанын, дынчанын, зынчанын, зынчанын  
бай жас түркес жас түркес  
Маки ти жарын зынчанын, зынчанын  
з'юнхол ти айлек ти маки ти жарын.

Айлек ти маки ти жарын  
жарын зынчанын, зынчанын  
з'юнхол ти айлек ти маки ти жарын  
з'юнхол ти айлек ти маки ти жарын.

## G J Y S H È T

Gjyshët tanë me kërrabë e hosten  
në male qëndruan përherë.  
Gjyshët tanë të mirë, të parruar  
kurrizin s'e kthyen nga era.

U vranë për sinor e për toka,  
u vranë për ugar e për thekër.  
Po veç tyre, borës edhe erës  
s'guxoi të vijë në mal njeri tjetër.

Se mbi ugarin, grurin, sinorin,  
deshën sa asgjë tjetër lirinë.  
Me njëri-tjetrin përballë agresorit  
s'kujtuan asnjëherë mërinë.

Armiqve që erdhën, gojën ua mbyllën,  
kufomat gjer në lumë ua hoqën zvarë,  
se s'duronte mali këmbë armiku,  
se mali të zgjedhur i do varret.

## B I L B I L E J T È

*Bilbilejtë trembëdhjetë,  
vanë në litarë vetë.*

Trembëdhjetë trima zbresin nga malet,  
zbresin si shqipet nga retë,  
rrihen tirqet në palë fustanelle,  
zbresin në mejdan trembëdhjetë.

Tymosin trembëdhjetë çibukë,  
krehin mjekrat me cep jatagani.  
Buzët përgjak perandoria turke,  
mustaqet me dhëmbë bren sulltani.

Afrohen në valle trembëdhjetë,  
të trembëdhjetë me zë bilbili.  
Në mjekra janari me forcë u ngjesh retë,  
pranverën në sy u ngjesh prilli.

Përthyejnë gjunjët trembëdhjetë trekëmbësha,  
xhelatët shpejtojnë frysëmarrjen.  
Me këngë në buzë, në brez jataganë,  
shqipëtari si vallen bën varjen.

Vetëm shqiponja ngjan me ta në vdekje,  
s'di të ngordhë pëgërrë si çdo shpend.  
Me krahë gjysmëhapur, që prej reve  
kërkon vdekjen plasur me shkëmbinjtë.

Shqiponja e vdekjes

Shqiponja e vdekjes

Të dhënë s'ndryshim, t'kam  
Të dhënë s'ndryshim, t'kam  
Të dhënë s'ndryshim, t'kam  
Të dhënë s'ndryshim, t'kam

Të dhënë s'ndryshim, t'kam  
Të dhënë s'ndryshim, t'kam  
Të dhënë s'ndryshim, t'kam  
Të dhënë s'ndryshim, t'kam

Aldhën, që nuk është e  
Aldhën, që nuk është e  
Aldhën, që nuk është e  
Aldhën, që nuk është e

## UDHËVE TË HEKURTA

Digjen, digjen yje  
si copa eshke,  
shami aksioni  
qielli mbi bjeshkë.

Shpërthen një minë,  
copëtohet një shpellë,  
ngrihet rishtaz tymi  
mbi mal fustanellë.

Këto male në çdo hap  
i ka parë çdo shekull  
me pushkë në sup,  
legjenda nën sqetull.

Ku gjyshët tanë  
ecën në gjak,  
vetullat shpata,  
sytë copa flake.

Me muskuj të enjtur,  
fustanella tëndë,  
mes ajrit të lehtë,  
nën zgjedhën e rëndë.

Mijëra agresorë  
shkelën këto anë,  
por mbetën përrënje  
veç marka jataganësh.

Të tjerë agresorë,  
të tjera marka,  
u ngjitën mbi male,  
shkelën mbi harta.

Por para vdekjes  
njohën me ngut  
tyta pushkësh mprehur  
në këngë lahute.

Ndaj çdo pjesë e tokës  
mbushur gjak ka venat  
si ne në mendime  
shinat plot me trena.

Kashtën e Kumrit  
agimi e djeg,  
gjymtyrë të hekurta  
ne zgjasim në breg.

## USHTARËT QË S'U KTHYEN NË ATDHE

Ikën gjenerali me kocka ngarkuar,  
me hartën e të vdekurve në duar.

Gjenerali kërruset, thinjet edhe hesht,  
mundohet të mbajë kockat në rresht.

Kockat sa prekin në pëllëmbën e tij,  
kërcasin me urrejtje, lart ngrihet tym e hi.

Citojnë rrasat emrat e ushtarëve,  
hapen me tallje gojët e varreve.

Ulërijnë ushtarët që s'u kthyen në atdhe:  
— Gjeneral, e sheh... gjeneral, e sheh?

## C U J U A N

*Poetit kombëtar kinez që jetoi e mendoi gjithë jetën e tij për popullin. Ai jetoi 27 shekuj përpara, pozëri i tij dhe sot tingëllon i artë.*

«Dhe nëntë herë i varur, nuk ndryshoj,  
s'do t'i them të bardhës kurrë «e zezë»!  
Unë vetëm popullin njoh e atë besoj,  
diellin e së vërtetës veç ai di ta ndezë.


Kur të shohësh, or Çing<sup>(1)</sup>, grushtin e tij,  
se je më i vdekshmi do ta kuptosh shpejt.  
I pavdekshëm është ai që lufton për liri,  
i pavdekshëm është ai që bën luftë të drejtë».

---

1. Mbreti që hipi në fuqi asaj kohe e që ndoqi poetin këmbës.

Kaq tha Çu Juan dhe u shkri me lumin Mi Lo,<sup>(2)</sup>  
 si lëvere bajameje gjithë intrigat u kalbën.  
 Vetëm populli nga fjalët e tij s'u tremb,  
 ndiente si rrihte poeti për liri këmbanën...

## ІТАЛІА ТЭДОЛЧ




---

2. Në lumin Mi Lo poeti jetoi ditët e fundit të jetës i  
 vetmuar.

Qëndrimi i moshëve të lirë është që nuk ka rregullat e  
vjetoreve, që nuk ka rregullat e vjetoreve, që nuk ka  
rregullat e vjetoreve, që nuk ka rregullat e vjetoreve, që nuk ka  
rregullat e vjetoreve, që nuk ka rregullat e vjetoreve, që nuk ka

## PROLETARIATI

S'është shpikje filozofësh,  
marrëveshje afaristësh,  
kontratë presidentësh.

Është ai  
dragua miliona krahësh  
që shohin në të vërtetë uriturit.

Është ai që s'fal,  
që u shkul dhëmballët miliarderëve,  
fronet presidentëve,  
kapitalizmit frymën.

Është ai që kthen  
vilat e borgjezëve në arkivole,  
prangat në grushta,  
gjakun në flamuj të kuq  
sa hemisferat.

Eshtë proletariati —  
sintezë e revolucionit  
që vendos vetë fatet e botës.

Eshtë ai  
që s'njeh marrëveshje,  
falsifikim, kompromis.

Eshtë ai  
që vdes një botë  
e mëkëmb një botë tjetër  
duke mbajtur në dorë  
flamurin e Marksizëm-Leninizmit  
shpalosur në kontinentë.

— itarishin qid  
shqyeni qid  
shqyeni qid  
shqyeni qid

ZGJOHU, DRUVAR

Pablo Nerudës, poetit komunist kili-  
lian që u masakrua nga forcat mer-  
cenare.

Plumba antikomunistë  
ta shpuan tavolinën, druvar.  
Shpërndahet mbi të gjaku  
i Nerudës së vrarë.

Gjaku dhomën mbush,  
shqyen natën kiliane.  
— Zgjohu, zgjohu druvar!  
Pablo Nerudën ta vranë.

Ngreje sëpatën, druvar,  
ti që përbys pyjet.  
Gjiri yt pa këngë Nerude  
është si nata pa yje.

Lajmëro shpejt gjithë negrit,  
bujqit, punëtorët, hamallët.  
Lajmëro ata që nën armë  
me forcë rrinë ushtarë.

Lajmëro refugjatët, të sëmurët,  
ata që kanë shpellat strehë.  
Lajmëro të vejat, jetimet,  
atë që bukën ende s'njeh.

Shndërroi, miku im druvar,  
shndërroi pyjet në trumpetë,  
pre me sëpatë dhe do dëgjosh  
nga plagët e druve «Duam poetin!»

Vargjet «Bukë e paqë botës!...»  
i skuq gjaku i poetit të vrarë.  
mbi natën e zezë kiliiane,  
eheheej!... Godit, druvar!...

## PASQYRA E LËNDËS

Parti .....	3
Krenari .....	4
Endrra e një bariu në plazh .....	5
Korrëset .....	6
Kostumet kombëtare .....	8
Vdekja e Naimit .....	9
Lirikë e vajzave të fshatit tim .....	10
Rroftë Partia Komuniste .....	11
Baladë për Memo Meton .....	12
Bluzat .....	14
Partizanes me emrin e lirisë .....	15
Përjetësi .....	17
Dialog në qeli .....	18
Atyre që na lan këngët .....	19
O këngët vënçe .....	20
Lirikë e maleve të mia .....	22
Këngë në male .....	24
Bari mes barinje .....	25
Mesnatë detare .....	26
Betonieres .....	27
Tek vaditet misri .....	28
Vrasja e Ballanit .....	29

Clodhja e agronomit .....	30
Nëpër gërshefat e blerta .....	31
Monolog për nënën .....	32
Fëmijnia .....	35
Lejlekët .....	36
Motiv kurbeti .....	38
Përcjellja e poetit De Radë .....	40
Gjyshët .....	42
Bilbilejtë .....	43
Udhëve të hekurta .....	45
Ushtarët që s'u kthyen në atdhe .....	47
Cu Juan .....	48
Proletariati .....	50
Zgjohu, druvar! .....	52